

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6897
E mërkurë, 17 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Partia Socialiste në
Shqipëri fiton 53 bashki,
opozita vetëm 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA KËRKON ZBATIM TË PLOTË TË MARRËVESHJES, SERBIA TË ASOCIACIONIT



Kosova dhe Serbia më 27 shkurt në Bruksel arritën marrëveshje për normalizim të raporteve, ndërkaq më 18 mars në Ohër u pajtuan për aneksin e zbatimit të


saj. Por deri më sot asnjë veprim i zbatimit të saj në praktikë nuk është marrë dhe dialogu ka ngecur. Kosova po kërkon zbatimin e plotë të marrëveshjes,

ndërkaq Serbia zbatimin e Asociacionit. Përfaqësuesit ndërkombëtarë po bëjnë thirrje që të dyja palët të ecin përpara në këtë proces

MIRATOHET KËRKESA E MBROJTJES E VESELIT PËR TË SHTUAR NJË DOKUMENT NË LISTËN E PROVAVE



PËRKUJTOHET ATDHETARI UKSHIN HOTI NË 24-VJETORIN E ZHDUKJES ME DHUNË NGA FORCAT SERBE



AKTUALE




BE-JA MBËSHTET AKTIVITETET PËR KONTROLLIN E ARMËVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

HYN NË FUQI RREGULLORJA E BE-së PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

KOMUNA E PRISHTINËS FILLON ORËN E LEXIMIT NË TË GJITHA SHKOLLAT

EKONOMI



VONESAT PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE ME SERBINË PENGOJNË PROSPEKTET E RRRITJES EKONOMIKE TË KOSOVËS

PËRFAQËSUESIT E ATK-së MBAJNË TAKIM ME TATIMPAGUES NGA SEKTORI I NDËRTIMTARISË

SPORT



ADIL MALIQI EMËROHET PËRZGJEDHËS I RI I PËRFAQËSUESES U19

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja mbështet aktivitetet për kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor

BRUKSEL, 16 MAJ - Në Bruksel të martën është zhvilluar një takim për kontrollin e armëve të zjarrit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe parandalimin e trafikimit të tyre. Në këtë takim, përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, tërhoqi vërejtjen se rreziku nga këto armë nuk është vetëm në teori, por i vërtetë.

Borrelli, duke iu referuar rasteve të vrasjeve në Serbi, tha se është e gabuar të mendohet se gjëra të tilla nuk mund të ndodhin në Evropë sepse, siç tha ai, ato po ndodhin. “Në mënyrë që rastet e tilla të ndodhin, kryesit e veprimt duhet të kenë qasje në armë, që bën që kjo konferencë të tërheqë edhe më shumë vëmendje dhe interes. Sepse rastet e tilla dramatike na rikujtojnë se sa e rëndësishme është që të punojmë së bashku për ta luftuar trafikimin e armëve të lehta”, tha Borrelli. Ai nënvizoi se është detyrë e të gjithëve që ta bëjnë Evropën më të sigurt në këtë kohë sfidash.

Përfaqësuesi i lartë i BE-së përshëndeti edhe fushatën e mbledhjes së armëve që ka nisur Qeveria e Serbisë pas rasteve tragjike dhe tha se BE-ja e mbështet këtë fushatë. Ai, po

ashtu, nënvizoi rëndësinë e angazhimit të gjerë nga ana e BE-së, duke përfshirë edhe Komisionin Evropian, Këshillin, Shërbimin e Jashtëm dhe Presidencën suedeze, për ta ndihmuar rajonin e Ballkanit Perëndimor që të luftojë kundër dhunës dhe trafikimit të armëve, në mënyrë që të ndihmojë “në parandalimin e kontaminimit të të gjithë Evropës”.

Shpesh shërbimet e vendeve anëtare të BE-së kanë tërhequr vërejtjen se sasi të mëdha të armëve ilegale vijnë në tregun e BE-së pikërisht nga rajoni i Ballkanit dhe rrjetet e kimit të organizuar nga këto vende janë aktive në BE. “Të gjithë e dimë se ky aktivitet, trafikimi ilegal i armëve, paraqet një rrezik të madh për paqen dhe stabilitetin tonë. Është një kërcënim i shumëfishhtë që ndikon në stabilitetin e rajonit dhe rrit rrezikun edhe nga sulmet terroriste”, ka deklaruar përfaqësuesi i lartë i BE-së duke shtuar se “nuk mund të ketë një Bashkim Evropian të sigurt pa pasur një Ballkan Perëndimor stabil, të fuqishëm dhe në paqe”. Bashkimi Evropian ka investuar deri tani 38 milionë euro vetëm në ndihmë për aktivitetet e kontrollit të armëve të lehta në



rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Problemi është shumë i thellë, shumë i madh, në mënyrë kronike godet shoqëritë e Ballkanit Perëndimor dhe ne duhet të jemi të vendosur për ta vazhduar luftën tonë kundër aktiviteteve të tilla, t’i vazhdojmë

investimet dhe angazhimin për t’u ndihmuar këtyre vendeve për ta zgjidhur këtë problem. Besoj se ne, Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor, ndajmë të njëjtin përkushtim për këtë”, theksoi Borrelli.

Në këtë takim foli edhe

komisionarja e BE-së për punë të brendshme, Ylva Johansson, e cila nënvizoi rëndësinë e masave për ta parandaluar trafikimin ilegal të armëve në rajon. Ajo, po ashtu, mirëpriti veprimet e autoriteteve në Serbi për grumbullimin e armëve pa leje.

Gjermania dënon pesë persona për grabitje stolish me vlerë 100 milionë euro



BERLIN, 16 MAJ - Një gjykatë gjermane dënoi të martën pesë burra për vjedhjen e bizhuterive të shekullit 18 me vlerë më shumë se 100 milionë euro nga një muze në qytetin e Dresdenit në vitin 2019. Ata u dënuan me burgim nga katër vjet e katër muaj dhe gjashtë vjet e tre muaj, njoftoi agjencia gjermane e lajmeve dpa. Një i pandehur u

shpall i pafajshëm.

Gjykata shtetërore e Dresdenit vendosi se pesë burrat e moshës 24 deri në 29 vjeç ishin përgjegjës për vjedhjen në Muzeun Green Vault të qytetit gjerman më 25 nëntor të vitit 2019 dhe vjedhjen e 21 bizhuterive që përmbanin më shumë se 4 300 diamante, me një vlerë totale të paktën 113.8 milionë euro.

Zyrtarët atëkohë patën thënë se bizhuteritë e marra përfshinin një karficë (brosh) të madhe diamanti dhe një epoletë të punuar me diamante (shenjë që vendoset mbi supe në uniformën ushtarake). Ata janë dënuar për shkak të lëndimeve trupore, vjedhje me armë, dëmtim të pronës dhe zjarrvënies me dashje.

Partia Socialiste në Shqipëri fiton 53 bashki, opozita vetëm 7

Tiranë, 16 maj - Numërimi i votave të zgjedhjeve të 14 majit në Shqipëri ka përfunduar në 59 bashki. Të martën ka vazhduar numërimi i votave për kryetar bashkie në Tiranë dhe Malësi të Madhe, por dallimi është i madh dhe nuk mund të ketë përmbyse të rezulttit; në avantazh janë kandidatët e Partisë Socialiste (PS). Për shpalljen e rezulttit zyrtar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do

ta presë edhe numërimin e votave për këshilltarët bashkiakë. Megjithatë, Komisionet Zgjedhore Zonale në 59 bashki i kanë shpallur tashmë rezultatet, ndërsa në dy të tjera ku po vazhdon numërimi është e qartë fitorja e thellë e socialistëve, prej ku 53 bashki do të drejtohen nga Partia Socialiste, shtatë nga koalicioni “Bashkë Fitojmë” i drejtuar nga Sali Berisha dhe Ilir Meta.

Bashkia e Finiqit në jug të vendit do të drejtohet nga partia minoritare greke, MEGA. Në reagimin e parë pas zgjedhjeve, kryetari i PS-së, njëherësh kryeministër i Shqipërisë, Edi Rama, tha se fitorja ishte e thellë, ndërsa pjesëmarrja e ulët, sipas tij, ishte bojkot i qytetarëve ndaj opozitës. Ndërkaq, liderët opozitarë të koalicionit “Bashkë Fitojmë” e kontestuan rezultatit të zgjedhjeve.



Komuna e Prishtinës fillon orën e leximit në të gjitha shkollat

PRISHTINË, 16 MAJ - Drejtoresha e Arsimit në komunën e Prishtinës, Besianë Musmurati, ka paraqitur të martën një projekt të ri që është duke e zhvilluar nëpër shkollat. Musmurati në "Facebook" ka shkruar se kanë filluar orën e leximit në të gjitha shkollat fillore të Prishtinës, për të gjitha klasat e para deri në klasën e pestë. "Bashkë me Agon A. Ahmeti nga ETEA, konceptin e kësaj ore të leximit e kemi marrë

nga Suedia dhe Kanada. Të dyja këto shtete kanë pasur probleme në lexim-kuptim të nxënësve dhe e kanë nxjerrë si politikë që ka dhënë rezultate konkrete. Së pari kemi blerë libra të rinj, në vlerë prej 100 mijë euro dhe do t'i shpërndajmë në shkollat. Fëmijët do të lexojnë libra që atyre u pëlqejnë. Do të lexojnë Utën e Maleve, Piter Panin, Princin e Vogël, Aventurat e Profesor Kantit, Çarlin që

transformohet në T-Rex, Ditarin e Djaloshit Nerd, do të mësojnë për Musinë Kokalarin, Greta Thunbergun, Nënë Terezën e shumë e shumë personazhe të tjera", ka thënë Musmurati. Ajo ka treguar se në Orën e Leximit nxënësit e klasave 1 deri në 5 të Prishtinës do të lexojnë libra që u pëlqejnë, që i kuptojnë dhe që do t'i komentojnë e analizojnë në klasë së bashku me shokët e klasës dhe mësuesin.



Miratohet kërkesa e mbrojtjes e Veselit për të shtuar një dokument në listën e provave

PRISHTINË, 16 MAJ - Në seancën e të martës, në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, trupi gjyqësor ka miratuar kërkesën e mbrojtjes së Veselit për të shtuar një dokument në listën e provave. Kjo kërkesë, sipas kryetarit të trupit gjyqësor, gjykatësit Charles Smith III, është kundërshtuar nga ana e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), raporton "Betimi për Drejtësi". "Në këtë rast bëhet shumë e vështirë për të gjitha palët, jo vetëm për palët, po edhe për ne, për t'u përgatitur si duhet. Kundërshtimi i ZPS-së është i kuptueshëm, megjithatë. Trupi gjyqësor do ta lejojë shtesën e provës materiale", tha ai. Gjykatësi Smith ka thënë se para se të vazhdohet me pyetjet nga mbrojtja për dëshmitarin e katërt me kodin 4748, do të diskutohet edhe një çështje tjetër e cila duhet të trajtohet në seancë private, e cila ka vazhduar në sesion privat. Gjatë muajit prill ka filluar gjykimi derisa në seancën e 3

prillit Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtësi i viktimave kanë paraqitur deklaratimet hyrëse dhe pas leximit të aktakuzës së ndryshuar nga ana e ZPS-së, ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, si dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, u deklaruan të pafajshëm për veprat penale që u vihen barrë. Më 4 prill mbrojtja e Thaçit, Veselit dhe Selimit kanë dhënë fjalën hyrëse derisa më 5 prill mbrojtja e Krasniqit ka dhënë fjalën hyrëse. Më 11 prill ka filluar paraqitja e provave të Prokurorisë, ku dëshmitarja e parë e mbrojtur e Prokurorisë ka dhënë dëshminë e saj më 11, 12 prill, 13 prill dhe më 17 prill. Më 17 prill ka filluar dëgjimi i dëshmitarit të dytë, po ashtu i mbrojtur, i cili ka vazhduar dhënien e dëshmisë edhe më 18, 19 prill dhe 20 prill, ku ka përfunduar dhënien e dëshmisë



edhe dëshmitari i tretë, kurse më 10 maj ka filluar dhënien e dëshmisë dëshmitari i katërt. Zyra e Prokurorit të Specializuar

më 30 shtator 2022 ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika me akuzë, ku këta të fundit ngarkohen për krime lufte e krime kundër njerëzimit. Më 29 prill 2022 Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, ku pretendohet se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë dhe Semetishtë. Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjen e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor. Aktakuzat ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.

Qeveria: Vënia e rinisë, në qendër të zhvillimit



PRISHTINË, 16 MAJ - Strategjia Shtetërore për Rini 2024-2032 dhe Plani i Veprimit 2024-2026 kanë hyrë në fazën fillestare të hartimit. Procesi është paraqitur të martën para krerëve institucionale, partnerëve strategjikë, deputetëve, zëvendësministrave, shoqërisë civile dhe pjesëmarrësve nga sektori i rinisë. Siç njofton Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryeministri Albin Kurti e vlerësoi atë si

dokumentin kryesor orientues afatgjatë për qeverinë karshi rinisë ngaqë, sipas tij, është strategji që na orienton drejt zhvillimit dhe është një mjet reformë për politikbërje ndërsektoriale. Ministri i MKRS-së, Hajrulla Çeku, ka theksuar se hartimi i këtij dokumenti që do të na tregojë shtegun drejt zhvillimit të qëndrueshëm për të gjithë të rinjtë, po bazohet në studimet e fundit dhe praktikatat më të mira në

dispozicion. "Koncept-dokumenti është artikuluar në mënyrë shumë konstruktive për tejkalimin e sfidave me të cilat përballen të rinjtë në vend", shtoi Arnhild Spence, koordinatore e UNKT-së për Kosovë. "I tërë procesi është rezultat i MKRS-së në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, me mbështetje të UNKT, në veçanti UNDP, UNICEF, UNFPA dhe IOM", ka njoftuar MKRS-ja.

Në muajin mars pati rritje të udhëtarëve në Aeroportin e Prishtinës

Prishtinë, 16 maj - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit për muajin mars 2023 me të dhëna mbi Transportin Ajror, Hekurudhor, Rrugor dhe Telekomunikimin. Në muajin mars 2023 numri i fluturimeve të realizuara ishte 722 ose (12.1 për qind)

më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 221 282 ose 13.7 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa numri i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi ishte 6 352 ose 7.4 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të

kaluar, ndërsa sasia e mallrave të transportuar në neto ton ishte 0. Numri i përdoruesve të rrjetit telefonik fiks ishte 68 243 ose 10.3 për qind më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa trafiku i realizuar (në minuta) ishte 3 134 330 ose 0.4 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.





Kosova kërkon zbatim të plotë të marrëveshjes, Serbia të Asociacionit

Kosova dhe Serbia më 27 shkurt në Bruksel arritën marrëveshje për normalizim të raporteve, ndërkaq më 18 mars në Ohër u pajtuan për aneksin e zbatimit të saj. Por deri më sot asnjë veprim i zbatimit të saj në praktikë nuk është marrë dhe dialogu ka ngecur. Kosova po kërkon zbatimin e plotë të marrëveshjes, ndërkaq Serbia zbatimin e Asociacionit. Përfaqësuesit ndërkombëtarë po bëjnë thirrje që të dyja palët të ecin përpara në këtë proces

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 MAJ - Në Bruksel është mbajtur të hënën raundi i ri i dialogut në mes të kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi dhe atij të Serbisë, Petar Petkoviç, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Takimi nuk ka dhënë asnjë rezultat megjithëse, sipas pjesëmarrësve, janë diskutuar një sërë temash. Ky raund bisedimesh kishte fokus zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe aneksit të saj.

Kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë se në takimin e 15 majit u bisedua se si palët e shohin drejtimin në të cilin po shkon procesi i dialogut. Ai tha se në agjendë të bisedimeve ishte "gjithçka që ka të bëjë me zbatimin e Marrëveshjes" së Ohrit. "Në marrëveshjen që arritëm në Ohër thuhet qartë se asnjë nga nenet nuk mund të kushtëzohen nenet e tjera dhe se të gjitha nenet do të zbatohen në mënyrë të pavarur. Po ashtu, thuhet se asnjëra palë nuk do të bllokojë zbatimin e ndonjë neni të caktuar. Ky është udhërrëfyesi për ne. Nuk besoj se ka gatishmëri nga BE-ja që t'i ikë një dokumentin që vetë e kanë sjellë dhe e kanë publikuar në uebfaqen e tyre", ka thënë Bislimi në fund të takimit.

Deri më tani nuk ka paralajmërime se cilat do të jenë hapat e ardhshëm

dhe kur do të takohen sërish Bislimi dhe Petkoviç.

Ndërkaq kryenegociatori i Serbisë, Petar Petkoviç, ka konfirmuar se pala serbe ka insistuar në formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë por që, sipas tij, nuk është e lehtë të bisedohet me Prishtinën.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të martën se formimi i Asociacionit është pjesë e marrëveshjes me Serbinë, por se marrëveshja për normalizimin e raporteve mes dy vendeve nuk e përmban vetëm nenin 7. Kurti ka thënë se pala e Kosovës e ka bërë të qartë edhe në takimin e së hënës në Bruksel se është e interesuar të zbatohet në tërësi marrëveshja, e jo vetëm neni 7 i saj, në të cilin flitet për formalizimin e statusit të Kishës Ortodokse Serbe e, po ashtu, për sigurimin e "një niveli të përshtatshëm të vetëqeverisjes". "Serbia dëshiron që ne të përqendrohemi vetëm dhe vetëm te neni 7. Natyrisht se neni 7 është pjesë e marrëveshjes, por neni 7 nuk është marrëveshja dhe këtë gjë zëvendëskryeministri Bislimi e ka bërë të qartë mbrëmë në Bruksel. Gjithashtu, kemi theksuar se dëshirojmë një plan zbatimi i cili është i hollësishëm, konkret, i balancuar dhe gjithëpërfshirës. Nuk mund të jetë plani i zbatimit i sekuencuar për marrëveshjen që e kemi bërë vetëm në nenin 7. Sa i përket nenit 7, pala serbe e ka rikonfirmuar se asaj nuk i interesojnë as Kushtetuta as

aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, por vetëm teksti që e ka nënshkruar ish-kryeministri Isa Mustafa", ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se ende nuk kanë marrë raport nga Bashkimi Evropian mbi denoncimet e Kosovës për shkeljet e marrëveshjes nga ana e Serbisë. "Në takimin e 2 majit të nivelit të lartë unë i kam dorëzuar një dokument me të gjitha shkeljet e Serbisë edhe të marrëveshjes bazike të 27 shkurtit në Bruksel, por edhe të marrëveshjes së Ohrit, mirëpo deri më sot nga ndërmjetësit nuk kemi një qëndrim të denoncimit tonë mbi shkeljet e Serbisë. Ne jemi të interesuar për zbatim të plotë e të menjëhershëm të marrëveshjes, pa kushte dhe pa vonesa. Pra është problemi te pala tjetër e cila nga pesë pikat e preambulës dhe 10 nenet e marrëveshjes, ajo dëshiron që ne të përqendrohemi vetëm te neni 7", ka theksuar Kurti.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të martën se kërkesat që Asociacioni të jetë parakusht për zbatimin e neneve të tjera të marrëveshjes Kosovë - Serbi nuk e ndihmojnë procesin e dialogut. Ajo ka theksuar se interpretimet e reja të BE-së që kërkojnë nga Kosova të dalë përtej asaj që është e shkruar në letër janë të gabuara.

Përkritazi me këtë, presidentja Osmani tha se Kosovës nuk duhet t'i kërkohej të bëjë diçka që fare nuk është në marrëveshje. "Ne presim që BE-ja mos të kërkojë të

zbatohen gjëra për të cilat nuk jemi pajtuar, ndërkaq të kërkohej pikërisht ajo për të cilën jemi pajtuar. Ne presim akoma që BE-ja të jetë e qartë për shkeljet e Serbisë. Deri më tani nuk e kemi parë një gjë të tillë", ka deklaruar Osmani. Ajo ka shtuar se Republika e Kosovës do të vazhdojë të ketë qasje jashtëzakonisht konstruktive në këtë proces.

Për takimin e 15 majit ka shkruar në "Twitter" i dërguari i BE-së, Miroslav Lajçak. Sipas tij, takimi i 15 majit synoi t'i "qartësonte çështjet e hapura". "Diskutimet do të vazhdojnë", theksoi ai.

Lajçaku para fillimit të këtij takimi në Bruksel kishte shkruar në rrjetet sociale se është i nevojshëm një fokus i plotë për normalizimin e raporteve dhe për zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit. Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë se Kosova ka obligim ta hartojë draftin për Asociacionin e se një version i tij nuk është i mjaftueshëm.

I pyetur se kush do të mund ta hartonte draftin më të mirë, Rhode tha se është vetë Kosova ajo që mund ta bëjë këtë. "Është përgjigje e thjeshtë. Versioni më i mirë, drafti më i mirë për Kosovën, mund të hartohet nga vetë Kosova. Mirëpo një version nuk është një draft, kështu që na duhet një draft nga Kosova së shpejti që ta shohim se çfarë ide konkrete ka për Asociacionin. Ky është obligimi i Kosovës që ta përshpejtojë procesin", ka thënë Rhode pas takimit me anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë. Kryetarja e Parlamentit Evropian (BE), Roberta Meola, ka bërë thirrje që Kosova dhe Serbia t'i zgjidhin çështjet e hapura. Kosova dhe Serbia më 27 shkurt në Bruksel arritën marrëveshjen për normalizim të raporteve,

ndërkaq më 18 mars në Ohër u pajtuan për aneksin e zbatimit të saj. Palët tashmë kanë shprehur qëndrime të ndryshme rreth prioriteteve sa i përket zbatimit të pikave të Marrëveshjes drejt normalizimit dhe aneksit të saj.

Qeveria e Kosovës insiston se duhet të zbatohen të gjitha pikat e marrëveshjes, por Beogradi këmbëngul që fillimisht të themelohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe.

Drafti i parë i statutit për themelimin e Asociacionit, që u prezantua në Bruksel më 2 maj, u refuzua menjëherë nga Qeveria e Kosovës dhe ky refuzim ishte i pritshëm për BE-në. Kryeministri Kurti kishte paraqitur një vizion të tij për vetëmenaxhimin e komunitetit serb në Kosovë, për të cilin ka thënë se ishte frymëzuar nga marrëveshja e Kroacisë me Serbinë.


Qeveria e Kosovës ka shkarkuar Ekëpin Menaxhues që ka hartuar statutin për Asociacionin, me arsyetimin se ky ekip e ka përfunduar mandatin me paraqitjen e draftit. Por, ky veprim i ekzekutivit të Kosovës në BE është konsideruar se është në kundërshtim me marrëveshjen e dialogut. Blloku evropian ka shprehur qëndrimin se ky ekip i përbërë nga katër anëtarë serbë duhet të jetë funksional deri në miratimin e statutit të Asociacionit.

Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin, më 2013 dhe 2015, por marrëveshja mbi parimet për themelimin e Asociacionit, sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nuk është në harmoni të plotë me aktin më të lartë juridik të shtetit. Megjithatë, Kushtetuesja ka thënë se ajo mund të harmonizohet me akte ligjore.

Përkujtohet atdhetari Ukshin Hoti në 24-vjetorin e zhdukjes me dhunë nga forcat serbe

PRISHTINË, 16 MAJ - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka përkujtuar atdhetarin Ukshin Hoti në 24-vjetorin e zhdukjes me dhunë nga forcat serbe. Ajo ka thënë se prej 24 vjetësh fati i atdhetarit e intelektualit Ukshin Hoti mbetet i pazbardhur, teksa emri i tij vazhdon të mbetet në listën e të zhdukurve me dhunë nga regjimi gjenocidal i Serbisë. "Më 16 maj të vitit 1999, pas lirimt nga Burgu i Dubravës, në rrethana ende të pandriçuara, ai është rrëmbyer me dhunë, teksa përpjekja për ta zbardhur fatin e tij nuk është ndalur asnjëherë. Besniku i idesë së Republikës është referencë jonë e vazhdueshme për angazhimin kombëtar. Ukshin Hoti është njeriu që mendimin politik dhe aktivitetin politik i bëri bashkë në dobi të mirë të përbushjes së idesë për Kosovën shtet. Sot e kujtojmë me respekt si simbol i Republikës, lirisë dhe demokracisë! Këto parime na udhëheqin në rrugëtimin e fuqizimit të shtetit, ndërsa angazhimi ynë për zbardhjen e fatit të tij nuk do të ndalet

asnjëherë", ka theksuar Osmani në deklaratën e saj për medie. Kryeministri Albin Kurti, në përkujtimin për Ukshin Hotin, ka theksuar se pas torturave që i përjetoi si i burgosur politik nga regjimi serb, u lirua nga burgu në mes të luftës. "Më 16 maj 1999, pas lirimt nga burgu i Dubravës, ai u zhduk", ka shkruar Kurti në "Facebook", duke shtuar se: "Zhdukja e tij është krim i pazbardhur i Serbisë. Zhdukjet me forcë gjatë luftës në Kosovë ishin pjesë e projektit serb 'Patkoi' për shfarosjen e shqiptarëve. Me deklaratën për personat e zhdukur, Serbia pas 24 vitesh ka pranuar krimin e zhdukjes me forcë gjatë luftës. Serbia ka hyrë në një marrëveshje ndërkombëtare me Republikën e Kosovës përmes së cilës ka pranuar obligimin ndërkombëtar që të jep çdo informacion, përfshirë ato të inteligjencës dhe ato ushtarake, të cilave pushteti atje u kishte dhënë status të klasifikuar për t'i ikur përgjegjësisë ndërkombëtare përmes fshehjes së dëshmimeve, për t'i dhënë përgjigje fatit të personave të zhdukur me



Andin Hoti për babanë: S'pata fatin të bëheshe udhërrëfyes i jetës sime, ama u bëre i fatit të popullit

Kryesuesi i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Andin Hoti, ka përkujtuar babanë e vet, Ukshin Hotin, në 24-vjetorin e zhduk-

jes. Ai në "Facebook" ka shkruar se edhe pse Ukshin Hoti nuk arriti të bëhej udhërrëfyes i jetës së tij, u bë udhërrëfyes i popullit shqiptar. "Nuk e pata fatin që të

bëheshe udhërrëfyes i jetës time, por ti u bëre udhërrëfyes i fatit të popullit tonë. 24 vjet dhimbje pa ty, 24 vjet me krenarinë që rritet çdo ditë", ka shkruar Hoti.

forcë në luftën e fundit në Kosovë. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk do të resht së kërkuari të vërtetën dhe drejtësinë për të zhdukurit gjatë luftës dhe të gjitha krimet e kryera nga Serbia". Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se Ukshin Hoti është i munguar vetëm fizikisht, sepse si veprimtar, intelektual e atdhetar, përgjatë gjithë veprimtarisë së tij, ka lënë

gjurmë të pashlyeshme në historinë e vendit tonë. "Ne nuk do të zbrapsemi asnjëherë duke kërkuar drejtësi e përgjegjësi për zhdukjen e dhunshme të profesor Hotit. Njëjtë si edhe për të gjithë 1 617 qytetarët e Kosovës të zhdukur me dhunë e të cilët figurojnë ende të pagjetur. Sepse ata, të gjithë, janë plaga jonë e hapur. Janë dhembja jonë e përditshme", ka theksuar Krasniqi.

Serbia rrezikon liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 16 MAJ - Komisioni Evropian ka pranuar se është i shqetësuar për ekzistimin e disa procedurave të lehtësuara për dhënien e shtetësisë të huajve nga ana e vendeve të cilat gëzojnë liberalizimin e vizave me Bashkimin Evropian.

Në këtë mënyrë, sipas një zëdhënësi të Komisionit Evropian, personat nga vendet e treta fitojnë mundësinë që t'i shmangin procedurat e Schengenit për t'u pajisur me viza dhe paraqesin edhe rrezik për sigurinë e vendeve të BE-së. Në mënyrë të veçantë Komisioni përmend Serbinë, e cila ka pasur një skemë të tillë. "Komisioni ka një shqetësim të përgjithshëm për versionet e ndryshme të skemave të dhënies së shtetësisë, siç është procedura e thjeshtëzuar për dhënien e shtetësisë pas një periudhe të shkurtër qëndrimi. Kjo mund të paraqesë rrezik publik dhe të sigurisë për BE-në, pasi Serbia gëzon lëvizje pa viza në BE. Komisioni do t'i monitorojë politikat e tilla të natyralizimit dhe dhënies së shtetësisë nga ana e shteteve që kanë liberalizim vizash në kuadër të mekanizmave për suspendimin e vizave", i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" një



zëdhënësi i Komisionit Evropian. Ai, po ashtu, ka theksuar se politika e vizave e vendeve fqinje ka një ndikim të madh në lëvizjen e imigrantëve drejt Bashkimit Evropian. "Në rastin e Serbisë, përshtatja me regjimin e vizave të BE-së është e rëndësishme për ta vazhduar përbushjen e kriterëve për liberalizim vizash. Serbia ka bërë një hap të rëndësishëm në përshtatjen e regjimit të saj të vizave me atë të BE-së. Komisioni inkurajon Serbinë t'i vazhdojë përpjekjet në këtë drejtim për të pasur një përshtatje të plotë", ka thënë Komisioni Evropian. Edhe më herët nga qarqet diplomatike në BE janë dëgjuar kritika ndaj Serbisë për heqjen e vizave për disa shtete të treta,

kryesisht kjo është bërë për shtetet të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës apo e kanë tërhequr një njohje të tillë. Disa shtete të BE-së kanë raportuar rritje të shpejtë të numrit të imigrantëve ilegalë dhe azilkërkuesve pikërisht nga këto shtete. Ndër vendet prej nga vijnë më së shumti migrantët janë përmendur Burundi, Kuba dhe Tunizia. Shtetas të këtyre vendeve kanë hyrë në Serbi pa viza dhe nga atje kanë kaluar në territorin e BE-së. Serbia është detyruar t'ua kthejë vizat këtyre shteteve sepse ishte kërcënuar se BE-ja se do ta suspendojë liberalizimin e vizave për Serbinë që është në fuqi që nga viti 2009. Por, vërejtje BE-ja u

ka dërguar edhe disa vendeve të tjera të rajonit, përfshirë edhe Shqipërinë.

Një shqetësim tjetër për BE-në është edhe skema e ashtuquajtur "pasaportat e arta" përmes të cilave disa vende të rajonit u japin shtetësi atyre që investojnë shuma të caktuara në këto vende. Skema të tilla kanë pasur edhe disa vende anëtare të bashkimit Evropian dhe Komisioni Evropian është shprehur se ato janë ilegale sipas ligjeve të BE-së. Prandaj Komisioni Evropian kërkoi edhe nga vendet e rajonit që të përmbahen nga skema të tilla. "Komisioni vazhdimisht u ka rekomanduar partnerëve nga rajoni i Ballkanit Perëndimor që t'i japin fund, apo të përmbahen nga vendosja e skemave 'shtetësi për investitorët', që njihet me termin 'pasaportat e arta', pasi ato paraqesin një varg rreziqesh për rendin publik dhe sigurinë e BE-së. Në veçanti këto skema u mundësojnë qytetarëve të vendeve të treta që të marrin shtetësinë e një vendi që gëzon liberalizimin e vizave dhe në këtë mënyrë ta fitojnë mundësinë për lëvizje pa viza në BE", ka thënë një zëdhënësi i Komisionit Evropian.

Disa diplomatë të vendeve të BE-së i kanë thënë "Radios Evropa e Lirë" se liberalizimi i vizave është bërë për t'u ndihmuar qytetarëve nga rajoni i Ballkanit Perëndimor për të udhëtuar në vendet e BE-së e jo për të mundësuar keqpërdorime me qëllime politike apo financiare për qeveritë e vendeve të rajonit. "Duhet të punojmë së bashku që ta evitojmë shndërrimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor në një derë për hyrje ilegale në BE", ka thënë një zyrtar i BE-së.

Komisioni Evropian vazhdimisht monitoron zbatimin e kriterëve për liberalizimin e vizave nga ana e vendeve të rajonit.

Përshtatja me regjimin e vizave të BE-së është një prej kushteve në të cilat Brukseli insiston gjithnjë e më shumë. Në rast të refuzimit të vendeve të rajonit për t'i përbushur kriteret, edhe pasi të ndodhë liberalizimi, BE-ja mban të drejtën për ta suspenduar liberalizimin e vizave.

Deri tash nuk ka ndodhur një gjë e tillë, por në BE thonë se vendet e rajonit nuk do të duhej të rrezikonin me heqjen e liberalizimit për qytetarët e tyre për përfitime politike apo financiare.



Nxënësit e IAAP “Fehmi Lladrovci” në infermieri, të parët në Kosovë për dhënien e ndihmës së parë

DRENAS, 16 MAJ - Një sukses i jashtëzakonshëm është arritur nga nxënësit e Institucionit Arsimit dhe Aftësimi Profesional “Fehmi Lladrovci” në Drenas, të cilët kanë arritur të zënë vendin e parë në kuadër të garave për ndihmën e parë, duke triumfuar ndaj të gjitha shkollave të mjekësisë në nivel

vendi të organizuar nga Kryqi i Kuq i Kosovës.

Vendi i parë në lëmin përkatës të nxënësve është dëshmi e një arsimimi të mirëfilltë që po zhvillohet në shkollat e komunës së Drenasit. “Për këtë falënderimi u takon mësimit dhe mësuesve që dhanë mësim adekuate dhe profesionale

si dhe nxënësve që ato mësimet praktikojnë si është më së miri. Komuna e Drenasit mbetet e përkushtuar të ofrojë kushte të nevojshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie bashkëkohore që nxënësit tanë të arrijnë suksese në fushat e tyre përkatëse”, ka njoftuar komuna e Drenasit.

Nënshkruhet marrëveshja për projektin “Fushata 30 ditore - Prishtina një qytet pa barriera”

PRISHTINË, 16 MAJ - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me ambasadorën e Vullnetit të Mirë për Kosovën, Elvana Shala, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për projektin “Fushata 30 ditore - Prishtina një qytet pa barriera”. “Qëllimi i këtij projekti është ta përmirësojmë infrastrukturën e Prishtinës dhe të sigurojmë qasje më të lehtë për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe kategoritë e tjera me vështirësi të ndryshme në lëvizje, në hapësirat e ndryshme të qytetit dhe në objekte institucionale private dhe publike. Bashkë të ndërtojmë një #kryeqytet më të përshtatshëm për të gjithë”, ka thënë Rama.



Në Prizren po jetësohet ideja që artistët ta kenë ambientin dinjitoz



PRIZREN, 16 MAJ - Po vazhdojnë punimet në renovimin e Shtëpisë së Kulturës “Xhemajli Berisha” në Prizren, projekt i cili është investim i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me vlerë prej 750 mijë eurosh. “Renovimi i tërësishëm i këtij objekti, që ekziston nga vitet ‘60, përveç se do t’i përmbushë të gjitha nevojat,

sidomos të artistëve të arteve dramatike, do të jetë fantastik për vizitorët e teatrit edhe nga aspekti estetik”, u shpreh kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj. Në kuadër të punimeve po ndërtohet edhe salla e ekspozitave për artet pamore, gjë që e kompletton tërësinë e këtij tempulli të kulturës.

Nënshkruhet kontrata për ndërtimin e shkollës në Dumosh të Podujevës

PODUJEVË, 16 MAJ - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka bërë me dije se është nënshkruar kontrata për ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Dumosh, në vlerë prej 560 mijë eurosh. Ky projekt do të financohet në tërësi nga

buxheti komunal, dhe brenda pak ditësh edhe do të fillojnë punimet. “Angazhim maksimal deri në realizimin e secilit projekt të premtuar para qytetarëve. Punë të mira e projekte të mëdha e presin Llapin”, ka shkruar Bulliqi në “Facebook”.



Mehaj falënderon Turqinë për mbështetjen në zhvillimin e kapaciteteve të FSK-së

PRISHTINË, 16 MAJ - Në vazhdim të takimeve me përfaqësuesit e korit diplomatik në Kosovë, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili. Me këtë rast, ministri Mehaj ka shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për mikpritjen nga ana e Republikës së Turqisë me

rastin e vizitës së tij, për bashkëpunim e ngushtë në mes të dyja vendeve si dhe për ndihmën dhe mbështetjen e ofruar në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale ushtarake të FSK-së. Në këtë takim u bisedua për mundësinë e ofrimit të përkrahjes së vendit tonë për proceset e rëndësishme që është duke

kaluar, siç është mbështetja në procesin e Partneritetit për Paqe.

Gjithashtu, u diskutuan mundësitë e zgjerimit të mëtejshëm të bashkëpunimit bilateral, veçanërisht në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, ku u theksua mundësia e shtimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e arsimimit dhe trajnimeve ushtarake dhe shkëmbimin e personelit.



Themelohet Shoqata e re e Miqësisë Kosovë - Austri, partneritet i palëkundur mes dy vendeve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në ceremoninë e themelimit të Shoqatës së re të Miqësisë Kosovë - Austri. Duke shprehur kënaqësinë që ishte i pranishëm në këtë ngjarje të veçantë, kryeministri Kurti ka theksuar se kjo është ngjarja e katërt në 10 ditët e fundit të këtij muaji ku në qendër të vëmendjes është bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Austrisë. "Austria është një

partnere e palëkundur e Kosovës si para ashtu dhe pas pavarësisë së vendit, duke ofruar mbështetje dhe ndihmë në një sërë fushash - nga zhvillimi ekonomik e deri te bashkëpunimi në fushën e sigurisë. Këtë vit, bashkë me 15-vjetorin e shpalljes së pavarësisë, shënuam edhe 15-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve tona", ka thënë kryeministri Kurti dhe ka treguar se Austria ishte ndër shtetet e para që mirëpriti dhe mbështeti

aplikimin tonë në Bashkimin Evropian dhe ndër shtetet që me votë dëshmoi mbështetjen e saj për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës. "Dhe për këtë i jemi gjithsesi mirënjohës", është shprehur Kurti.

Më tej, kryeministri potencoi faktin se Austria ka ofruar mbështetje ndër vite për Kosovën përmes ekspertëve duke ndihmuar në forcimin e institucioneve tona dhe promovimin e qeverisjes së mirë. "Shkëmbimet tregtare ndërmjet

dy vendeve tona kanë shënuar trend pozitiv. Vetëm në dy vitet e fundit (2020-2022) eksportet drejt Austrisë janë rritur për 120 për qind, ndërkohë që investimet e huaja direkte vitin e kaluar, pra në vitin 2022, ishin dyfish më shumë se në vitin pararendës 2021", ka theksuar Kurti.

Ai ka shtuar se "megjithatë, partneriteti ynë me Austrinë është më shumë se thjesht një komoditet apo mall. Ai bazohet në një angazhim të përbashkët ndaj vlerave të demokracisë, të

drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës. Ne ndajmë një vizion për një Evropë paqësore, të begatë dhe të integruar, ku të gjithë kombet dhe popujt zhvillohen dhe janë të barabartë", ka vlerësuar kryeministri Kurti.

Kurti ka thënë se nga sot themelimi i shoqatës së re të miqësisë kosovare-austriake do të jetë një tjetër pikënisje për zgjerim të kontakteve dhe shumëzimit të urave të bashkëpunimit ndërmjet popujve, shteteve dhe bizneseve të të dy vendeve tona.

Hyn në fuqi rregullorja e BE-së për liberalizimin e vizave

Prishtinë, 16 maj - Janë bërë të gjitha hapat për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Instituti EPIK ka njoftuar se të hënën ka hyrë në fuqi Rregullorja e BE-së 2023/850 e cila mundëson liberalizimin e vizave për Kosovën. "Nga sot fillon zbatimi i Rregullores së

BE-së 2023/850. Me fjalë të tjera, nga sot liberalizimi i vizave për Kosovën është ligj i aplikueshëm në të gjithë zonën Shengen. Ndonëse praktikisht qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin lirshëm drejt zonës Shengen nga 1 janari, nga sot autoritetet

kufitare të BE-së fillojnë përgatitjet e nevojshme për të siguruar se nga 1 janari legjislacioni respektiv do të zbatohet në të gjitha pikëkalimet kufitare të zonës Shengen", ka bërë me dije drejtori i këtij instituti, Demush Shasha.



Përfaqësuesit e ATK-së mbajnë takim me tatimpagues nga sektori i ndërtimitarisë

PRISHTINË, 16 MAJ - Drejtori ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, dhe zëvendës drejtori ekzekutiv Sami Salihu, kanë mbajtur takim me tatimpagues nga sektori i ndërtimitarisë. Në këtë diskutim të organizuar nga kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, është diskutuar rreth përmirësimit të përmbushjes tatimore në sektorin e ndërtimitarisë, si një ndër sektorët me risk të konsiderueshëm.

Drejtori Murtezaj gjatë fjalës së tij ka vlerësuar bashkëpunimin e institucionit që drejton dhe komunitetit të bizneseve pasi që,

sipas tij, kjo është mënyra e vetme përmes së cilës më së lehti dhe në mënyrë profesionale mund të adresohen dhe zgjidhen të gjitha pengesat dhe shqetësimet që mund t'i kenë tatimpaguesit në raport me procedurat tatimore. Ai përmendi qasjen e ATK-së karshi tatimpaguesve të këtij sektori të cilët kanë tendencë të mos deklarimit të saktë të obligimeve tatimore.

Drejtori i ATK-së ka potencuar është duke zbatuar projektin e ndërtimitarisë, nga i cili sipas tij, deri më tani kanë arritur të kenë rritje të përmbushjes tatimore. Nga ana tjetër, zëvendës drejtori

Salihu gjatë pjesës së diskutimit me pjesëmarrësit foli rreth qëllimit të projektit, por edhe rreth vështirësive me të cilat ATK-ja ballafaqohet me këtë sektorë, si dhe gjendjen aktuale që kanë në terren, ku dihet se tani veç jemi në sezonin, kur ky sektor rrit aktivitetin.

Ndërsa kryetari i Shoqatës së Ndërtimitarisë, Faton Hoxha, ka thënë se për shkak të ndjeshmërisë dhe natyrës së aktivitetit që ka ky sektor, shpreson të kenë bashkëpunime të niveleve të tjera, të cilat u mundësojnë efikasitet më të shpejtë në çfarëdo çështje që mund ta kenë.




Vonesat në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë pengojnë prospektet e rritjes ekonomike të Kosovës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 MAJ - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shprehur qëndrimin e saj se normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të sillte përfitime të konsiderueshme për komunitetin e biznesit në Kosovë, duke përfshirë rritjen e mundësive për tregti dhe investime, të cilat do të ndihmonin në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. "Oda Amerikane u bënë thirrje të dyja shteteve të angazhohen për dialog konstruktiv dhe t'i zbatojnë zotimet e të gjitha marrëveshjeve të mëparshme nga të cilat do të përfitonin Kosova dhe Serbia. Pavarësisht prej përpjekjeve të Kosovës për të tërhequr investime të huaja direkte, përmes ndërmarrjes së hapave të rëndësishëm vitet e fundit për ta përmirësuar klimën e saj të investimeve, duke reduktuar burokracinë dhe duke zbatuar reforma për lehtësimin e të bërit biznes, vendi është ballafaquar me vështirësi në tërheqjen e niveleve të konsiderueshme të investimeve", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

Sipas kësaj komunikate, tensionet e vazhdueshme politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e



Kosovës për të tërhequr investime të huaja direkte. "Çështjet e pazgjidhura mes dy vendeve kanë krijuar një mjedis të paqëndrueshëm që është dekurajues për bizneset e huaja të investojnë në Kosovë, pasi investitorët hezitojnë t'i investojnë paratë e tyre në një vend me një nivel të lartë të pasigurisë politike, i cili rrit rreziqet që lidhen me investimet e tyre. Përveç kësaj, mungesa e një marrëveshjeje formale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka krijuar pengesa për bizneset në aspektin e logjistikës,

transportit dhe tregtisë, gjë që i pengon edhe më tej investimet e huaja përgjatë rajonit", theksohet në komunikatë.

Përveç kësaj, Oda Ekonomike Amerikane ka theksuar se çështja e pazgjidhur me Serbinë ka çuar në humbjen e mundësive për bizneset kosovare, veçanërisht në aspektin e tregtisë dhe investimeve. "Situata aktuale ka kufizuar mundësitë për bizneset kosovare që të arrijnë partneritet me investitorët e huaj dhe për t'i zgjeruar operacionet e tyre. Humbja e mundësive për

investime ka penguar rritjen e bizneseve kosovare, gjë që ka pasur një efekt negativ në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Mungesa e një marrëveshjeje formale mes dy vendeve ka rezultuar në barriera tregtare duke e bërë të vështirë për bizneset kosovare që të eksportojnë mallra dhe shërbime në Serbi si dhe duke penguar aftësinë e tyre për të konkurruar me bizneset serbe në rajon. Kjo ka çuar në humbjen e mundësive afariste për firmat kosovare, gjë që ka penguar rritjen dhe zhvillimin

ekonomik të vendit", thuhet në komunikatë.

Oda Amerikane më tej thekson se beson fuqishëm se normalizimi i marrëdhënieve do të krijonte një mjedis politik më të parashikueshëm, i cili do ta rriste besimin e investitorëve dhe do të inkurajonte më shumë investime të huaja direkte, gjë që është kritike për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. "Në anën tjetër, kjo do të krijonte mundësi punësimi, do t'i përmirësonte standardet e jetesës dhe do ta zvogëlonte më tej varfërinë, nga e cila do të përfitonte populli i Kosovës", është thënë në këtë komunikatë. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë rithekson se normalizimi i marrëdhënieve do ta rriste integritetin tregtar dhe ekonomik mes dy shteteve, gjë që do të krijonte mundësi të reja për bizneset në Kosovë për të hyrë në tregje më të mëdha, duke përfituar nga ekonomitë e shqallës. "Kjo do të ndihmonte në diversifikimin e ekonomisë së Kosovës dhe zvogëlimin e varësisë së saj nga sektori i shërbimeve dhe remitancat nga diaspora. Krejt në fund, normalizimi i marrëdhënieve do të kishte edhe përfitime të rëndësishme politike dhe sociale duke ulur tensionet dhe duke promovuar stabilitetin rajonal, gjë që do ta përmirësonte cilësinë e jetës për të gjithë njerëzit në rajon", thuhet në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

Jetësohet iniciativa për themelimin e Qendrës Rajonale-Balkanike për trajnime dhe certifikime në Kosovë

PRISHTINË, 16 MAJ - Duke pasur parasysh nevojën për një qendër nacionale të trajnimit dhe certifikimit të punëtorëve, Oda Ekonomike e Kosovës ka realizuar një varg takimesh me palë relevante për jetësimin e iniciativës për themelimin e Qendrës Rajonale për Trajnime dhe

Certifikime e cila gjendet në Ferizaj.

Meqë Oda Ekonomike e Kosovës është anëtare dhe njëkohësisht udhëheqëse e Forumit Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor (CIF), kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna, pas takimeve të bordit menaxhues të CIF, ka

iniciuar themelimin e qendrës rajonale-balkanike të trajnimeve dhe certifikimeve, me bazë në Ferizaj. Kjo qendër do të shërbejë për të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, për t'i trajnuar dhe certifikuar punëtorët e ndërmarrjeve që janë pjesë e këtyre ekonomive.



Çfarë i shkakton njeriut izolimi ekstrem? Historia e gruas që kaloi 500 ditë e vetme në një shpellë



Nga Ruth OGDEN

Të jetuarit për një vit e gjysmë vetëm në një shpellë, mund të duket si një makth për shumë njerëz. Por atletja spanjolle Beatriz Flamini doli e buzëqeshur nga aty, dhe tha se mendonte se kishte pasur më shumë kohë për të përfunduar librin e saj.

Ajo ishte privuar nga çdo kontakt me botën e jashtme gjatë eksperimentit të saj mbresëlënës në lidhje me qëndrueshmërinë njerëzore. Për 500 ditë, dokumentoi përvojat e saj, që t'i ndihmojë shkencëtarët të kuptojnë efektet e izolimit ekstrem. Një nga gjërat e para që u bë e dukshme në 12 prill 2023 kur ajo doli nga shpella, ishte se sa fluide është koha.

Ajo formëson më shumë nga tiparet e personalitetit vetjak dhe njerëzit përreth jush sesa nga një orë që kalon. Kur bisedonte me gazetarët për përvojat e saj, Flamini shpjegoi se e humbi shumë shpejt ndjenjën e kohës. Ajo ishte aq e madhe sa që kur ekipi i saj mbështetës shkoi për ta marrë, Beatriz u befusua kur i thanë se kishte mbaruar koha e eksperimentit.

Ajo vetë besonte se kishte qenë në shpellë për 160-170 ditë. Po pse e humbi ndjenjën e kohës?

Veprimet, emocionet tona dhe ndryshimet në mjedisin përreth nesh, mund të kenë efekte të fuqishme tek mënyra sesi e përpunojnë kohën mendjet tona. Për shumicën e njerëzve, lindja dhe perëndimi i diellit shënojnë kalimin e ditëve, dhe rutinat e punës dhe ato sociale shënojnë kalimin e orëve.

Në errësirën e një shpelle nëntokësore, pa shoqërinë e të tjerëve, zhduken shumë sinjale të kalimit të kohës. Pra për monitorimin e kalimit të kohës, Flamini mund të jetë bërë më e varur nga proceset psikologjike. Një nga mënyrat sesi ne mbajmë gjurmët e kalimit të kohës është kujtesa.

Nëse nuk e dimë për sa kohë kemi bërë diçka, përdorim numrin e kujtimeve të formuara gjatë ngjarjes si një indeks të sasisë së kohës që ka kaluar. Sa më shumë kujtime të krijojmë në një ngjarje apo epokë, aq më gjatë e perceptojmë se ka zgjatur ajo. Zakonisht, ditët dhe javët më të ngarkuara, të mbushura me shumë ngjarje të reja dhe emocionale, mbahen mend si më të gjata se sa ato më monotone ku nuk ndodh asgjë e rëndësishme.

Për Flamini, mungesa e ndërveprimit social, e kombinuar me mungesën e informacionit për

familjen dhe çështjet aktuale (lufta në Ukrainë, rihapja e shoqërive pas bllokimeve të Covid-19), mund ta ketë ulur ndjeshëm numrin e kujtimeve që ajo formoi gjatë izolimit të saj.

Vetë Flamini deklaroi pas daljes nga shpella: "Mua më ka ngecur ora më 21 nëntor 2021. Nuk di asgjë se çfarë ka ndodhur më pas në botë". Humbja e ndjenjës së kohës mund të pasqyrojë gjithashtu reduktimin e rëndësisë që ka kohës në jetën brenda shpellave.

Në botën e jashtme, ngarkesa e jetës moderne dhe presioni social për të shmangur humbjen e kohës, nënkuptojnë se shumë prej nesh jetojnë në një gjendje të vazhdueshme të stresit ndajkohës. Për ne, ora është një matës se sa produktivë dhe të suksesshëm jemi ne.

Por Flamini nuk është e para që përjeton një ndryshim në përvojën e saj të kohës, pas një ndryshimi të tillë mjedisor. Përvoja të ngjashme u raportuan nga shkencëtari francez Mishel Sifre gjatë ekspeditave të tij në shpella nga 2-6 muaj në vitet 1960-1970.

Një humbje e ndjenjës së kohës, është raportuar vazhdimisht nga të rriturit dhe fëmijët që kaluan periudha të gjata të izolimit në bunkerë bërthamorë (për qëllime

kërkimore) në kulmin e Luftës së Ftohtë. Gjithashtu, raportohet shpesh nga njerëz që vuajnë dënime me burg dhe u përjetua gjerësisht nga publiku i gjerë gjatë bllokimeve të COVID-19.

Shpella, bunkerët bërthamorë, burgjet dhe pandemitë globale ndajnë dy karakteristika të përbashkëta, që duket se krijojnë një ndjenjë të ndryshuar të kohës. Ato na izolojnë nga bota e gjerë dhe përfshijnë hapësira të mbyllura. Megjithatë Flamini jetoj me një kalendar bosh që shtrihej në të ardhmen e saj.



Asnjë takim pune për t'u përgatitur, asnjë takim drejt të cilit duhet nxituar, dhe asnjë kalendar kontaktesh sociale për t'u menaxhuar. Ajo pati një jetë me një ritëm të pavarur, ku mund të hante, flinte dhe lexonte si dhe kur i pëlqente. Ajo merrej me pikturën, stërvitej dhe dokumentonte në një ditar përvojat e saj.

Kjo mund ta ketë bërë të parëndësishme kalimin e kohës. Ndërsa ritmet biologjike të gjumit, etjes dhe tretjes morën përparësi ndaj akrepave të orës, Flamini mund t'i ketë kushtuar gjithnjë e më pak vëmendje kalimit të kohës, duke bërë që ajo përfundimisht të humbasë gjurmët e saj.

Aftësia e Flamini për të lënë kohën

të rrjedhë, mund të jetë rritur nga dëshira e saj e fortë për të arritur qëllimin e saj të qëndrimit 500-ditor në shpellë. Tek e fundit, ajo vendosi vetë të hynte në shpellë dhe mund të largohej nëse donte. Por për njerëzit që mbyllen diku kundër vullnetit të tyre, koha mund të bëhet vetë një burg.

Të burgosurit e luftës dhe njerëzit që vuajnë dënime me burg, raportojnë shpeshherë se monitorimi i kalimit të kohës mund të shndërrohet në një fiksim. Duket që ne njerëzit jemi në gjendje ta lëmë vërtet kohën të rrjedhë vetëm kur e kemi nën kontroll. Liria e Flamini mund të bëjë që braktisja e civilizimit për një shpellë të duket si një perspektivë tërheqëse. Megjithatë, jeta nëntokë nuk është për ata me një zemër të dobët. Mbijetesa varet nga aftësia juaj për të mbajtur një nivel të lartë të qëndrueshmërisë mendore. Nëse keni aftësinë për të qëndruar të qetë kur gjërat vështirësohen, thelbësore është pasja e një besimi të fortë se i keni nën kontroll sjelljet tuaja. Megjithatë, mund ta keni më të thjeshtë të çaktivizoni njoftimet tuaja në celular, të pastroni kalendarin dhe të humbisni në një kohë të shkurtër. / "The Conversation" – Bota.al



Adil Maliqi emërohet përzgjedhës i ri i Përfaqësueses U19



PRISHTINË, 16 MAJ - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, e ka zyrtarizuar të martën përzgjedhësin e Përfaqësueses U19. Në këtë pozitë ai e ka emëruar Adil Maliqin, i cili e pason trajnerin Ramiz Krasiniqi, i cili tash e tutje do ta mbajë pozitën e koordinatorit në U19.

Adil Maliqi, i cili është lindur dhe rritur në Zvicër, ka të përfunduar akademinë e futbollit "Grasshopper Club Cyrih" dhe atë të "FC Winterthur". Si futbollist,

Maliqi ka qenë aktiv në Ligën e Parë të Zvicrës deri në vitin 2012. Ai më pas ka drejtuar disa klube amatore në Zvicër dhe ka një përvojë 11-vjeçare si trajner. Fillimisht ai u përzgjedh zëvendëstrajner në futbollin profesionist tek U15 në akademinë Wintertur, ndërsa më pas iu besua drejtimi i ekipit U17 me ç'rast kjo grupmoshë nën drejtimin e trajnerit Maliqi shënoi suksesin më të madh ndonjëherë. Në karrierën e tij si trajner ai ka fituar dy tituj me skuadrën "SV Wyrenlos" në Ligën e Tretë të

Zvicrës. Presidenti Ademi i uroi mirëseardhje në Kombëtaren e Kosovës trajnerit Maliqi duke i dëshiruar shumë suksese, po ashtu edhe rezultate të mira me grupmoshën U19. Nga ana tjetër, Maliqi e falënderoi presidentin Ademi për besimin e dhënë dhe premtoi se do të punojë me përkushtim për suksesin e "dardanëve". Trajneri Maliqi theksoi se pozita e përzgjedhësit të Përfaqësueses së Kosovës është ëndërr e kamotshme e tij, ndërsa përfaqësimi i shtetit të Kosovës përbën krenari.

Shqipëria mbështet kandidaturën e Kosovës për Lojërat Mesdhetare 2030

PRISHTINË, 16 MAJ - Shqipëria do ta mbështesë kandidaturën e Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030 dhe do ta lehtësojë procesin e përgatitjes dhe organizimit të garave të sportit të lundrimit në bregdetin shqiptar.

Ministria e Arsimit dhe Sportit e Shqipërisë, Evis Kushi dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i Republikës së Kosovës, Hajrulla Çeku, nënshkruan marrëveshjen që mbështet kandidaturën e Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030, ku Shqipëria

angazhohet për ta mbështetur Kosovën në lehtësimin e procesit të përgatitjes dhe organizimit të garave të sportit të lundrimit. Në takimin e zhvilluar mes dy ministrave përgjegjës për sportin në Shqipëri dhe Kosovë, ministrja Evis Kushi i ofroi homologut të saj mbështetje maksimale, duke u shprehur se Shqipëria është e vendosur ta forcojë bashkëpunimin me Kosovën në çdo fushë dhe nismat e ndërmarra mes dy qeverive të vijnë të zbatohen me sukses. Mes institucioneve të varësisë të

të dy ministrave përgjegjës për sportin në Shqipëri dhe Kosovë, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSh) dhe Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) do të ketë një koordinim në bregdetin shqiptar për procesin e përgatitjes dhe organizimit për zhvillimin e sportit të lundrimit si pjesë e programit të Lojërave Mesdhetare, Prishtina 2030, në përputhje me rregullat, standardet dhe kërkesat e Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare dhe organizatës ndërkombëtare të sportit përkatës.



Sot zhvillohet finalja e Kupës në konkurrencën e femrave



PRISHTINË, 16 MAJ - Finalja e madhe e Kupës së Kosovës në futboll në konkurrencën e femrave do të zhvillohet ditën e mërkurë. Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se finalja në mes të KFF Mitrovica dhe KFF EP Hajvalia do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". Kjo ndeshje do të luhet me fillim nga ora 17:00 në kryeqytet dhe për të do të përdoret edhe sistemi VAR.

FFK-ja u ka bërë ftesë të gjithë dashamirëve të futbollit të marrin pjesë në këtë ndeshje që pritet të jetë madhështore. "Të mërkurë në finalen e Kupës së Kosovës përballen dy skuadrat më cilësore në futbollin e femrave, KFF Mitrovica - KFF EP Hajvalia. Do të jetë kjo një betejë e fortë për trofeun e parë të edicionit. 'Fadil Vokrri' është gati për t'i pritur dy rivalët e mëdhenj

dhe tifozët e tyre, në një ndeshje ku do të përdoret edhe sistemi VAR. Ecuria e këtyre dy skuadrave gjatë këtij edicioni dhe fondi cilësor i futbollistëve bëjnë që kjo ndeshje të jetë atraktive dhe emocionuese. Ftojme të gjithë dashamirët e futbollit që të marrin pjesë në këtë spektakël të jashtëzakonshëm të futbollit të femrave", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Gjithçka gati për turneun tradicional 'Lah Nimani'

PRISHTINË, 16 MAJ - Federata e Boksit të Kosovës ka njoftuar se i ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e turneut tradicional ndërkombëtar, i 15-ti me radhë, "Lah Nimani". Ky turne do të organizohet më 20 dhe 21 maj në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë,

ndërsa pjesëmarrës do të jenë boksierët e rinj (Youth) U18 nga Bullgaria, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kosova. Gjysmëfinalja zhvillohet më 20 maj nga ora 16:00, kurse finalja më 21 maj nga ora 12:00. Gjyqtarë: Agim Shala, Agim

Tahiraj, Marigona Beadini, Fadil Bektashi, Visar Ibrahim, Granit Qorri, Luan Krasniqi, Agron Nushi, Filip Nue. Supervajzer: Sima Viorel. Vajzerë: Sylejman Voca, Nadir Shllaku. Mjekë kujdestarë: Agron Kamberi, Artan Lushaj.



Fury provokon rivalët: Dysjoj se kanë frikë të përballen me mua

LONDËR, 16 MAJ - Boksieri britanik Tyson Fury nuk arriti të organizojë dy duele të mëdha në harkun kohor të 7-8 muajve: Fillimisht ndaj patriotit të tij Anthony Joshua vjet në tetor e më pas ndaj ukrainasit Oleksandr Usyk këtë pranverë. Duke folur nga Tenerife,

boksieri britanik këmbënguli se ai ende dëshiron të përballen me Usyk dhe Joshua, por pyeti nëse rivalët e tij janë të interesuar të përballen me të. "Do të doja që këto dy duele të ndodhin në të ardhmen. Do të më pëlqente të ndodhte kjo gjë", ka thënë Fury për "Boxing Social". "Do të doja

të dueloja me Oleksandr Usyk dhe Anthony Joshua, por thjesht mendoj se janë ata që nuk duan të duelojnë me mua", u shpreh më tej boksieri kampion bote në peshën e rëndë. I pyetur në lidhje me mundësinë e organizimit të një sfide në Arabinë e Madhe, ai shtoi: "Ka

shumë gjëra që po ndodhin në Arabinë Saudite me të gjitha këto shuma masive parash që po fliten dhe mendoj se kjo e bëri më të mirën e Usyk. Tundimi i njëqind milionë apo 75 milionëve në vend që ta zhvillojmë tani në Britaninë e Madhe".



Interi mposhti sërish Milanin, kualifikohet në finale

MILANO, 16 MAJ - Interi është skuadra e parë finaliste e Ligës së Kampionëve për vitin 2023. Skuadra zikaltër ka arritur që të fitojë dhe sfidën e kthimit, 1-0 ndaj Milanit, duke siguruar biletën për në Stamboll. Ishte një pjesë e parë më e mirë për skuadrën e Piolit që ju afrua në dy raste golit. Fillimisht në minutën e 11-të Brahim Diaz humbi një mundësi të artë përballë portierit, ndërkohë që në minutën e 38-të, Leao e dërgoi topin ngjitur me shtyllën. Në pjesën e dytë, Milani vuajti shumë, ndërkohë që Interi administroi më së miri lojën, duke mos lejuar asnjë hapësirë, madje do të gjente dhe golin. Në minutën e 74-t, pas një aksioni të gjatë, Lautaro Martinez lirohet mjaft mirë nga mbrojtjes kuqezi dhe më pas me të majtën arrin që të mposht portierin Maignan. Minutat e fundit ishin thjeshtë një



formalitet, pasi asgjë nuk do të ndryshonte. Interi rikthehet në finalen e Ligës së Kampionëve pas 13 vitesh, kur për herë të fundit do të fitonte trofeun me "veshë të mëdhenj".

City - Real, sonte përcaktohet finalisti i dytë

MANCHESTER, 16 MAJ - Pas barazimit 1-1 në ndeshjen e parë në "Santiago Bernabeu", Real Madridi dhe Manchester City do të përballen sërish sonte (e mërkurë) në ndeshjen kthyesë të gjysmëfinale në Ligën e Kampionëve në "Etihad" për ta përcaktuar fituesin e kësaj përballje dhe kualifikimin në finalen e madhe. Vinicius Junior i kaloi në epërsi vendasit, ndërsa rezultatin e barazoi Kevin De Bruyne. Trajneri Pep Guardiola ka thënë se City është e vetmja në Evropë që po lufton për tre trofetë. Ai ka thënë se synim është kualifikimi në finalen e Ligës së Kampionëve. "Jemi e vetmja skuadër në Evropë që luftojmë për të gjitha kompeticionet. Jemi në finalen e Kupës kundër Unitedit dhe në fund të Premierë Ligës në rrugën e duhur. Por të luajmë në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve në shtëpi, përpara njerëzve tanë dhe duke u përpjekur për të arritur në finale, është një arritje e jashtëzakonshme", ka thënë Guardiola. Në këtë ndeshje në dyshim për Cityn është mbrojtësi Nathan Ake, në anën tjetër Real Madridi është i



Formacionet e mundshme:
Manchester City: Ederson; Walker, Dias, Akanji; Stones, Rodri; Silva, Gundogan, De Bruyne, Grealish; Haaland
Real Madrid: Courtois; Carvajal, Militao, Rudiger, Kroos, Camavinga, Modric; Valverde, Benzema, Vinicius

kompletuar për këtë ndeshje. Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, fillimisht është shprehur i kënaqur se skuadra e tij është në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve dhe se të gjithë lojtarët janë të gatshëm. "Për mua është e

rëndësishme që skuadra bëri mirë punën e saj dhe tani mbërrijmë në gjysmëfinalen e kthimit në Ligën e Kampionëve me të gjithë lojtarët të gatshëm dhe pa probleme. Kjo është shumë e rëndësishme", ka thënë Ancelotti.

SHKURT

KBF Prishtina, kampione e U16

KBF Prishtina është kampione e Kosovës e U16 në konkurrencën e femrave. Skuadra prishtinase në ndeshjen e tretë finale të "play-off"-it të zhvilluar në Pejë ka mundur Peja 03 me rezultat 39:61. Në finalen e parë të zhvilluar skuadra pejane kishte fituar me rezultat 62:54, ndërsa në sfidën e dytë finale kishin fituar prishtinaset 56:50. Peja në gjysmëfinale kishte eliminuar Junior 06 Moni Bau, ndërsa KBF Prishtina kishte mundur AA Prishtinën. Në garat e rregullta Peja 03 kishte 15 fitore e një humbje, kurse KBF Prishtina 13 fitore e tri humbje.

Bielsa, trajner i ri i Uruguait

Marcelo Bielsa rikthehet në bankinë. Trajneri argjentinas ka firmosur zyrtarisht marrëveshjen me Federatën Uruguaiane për ta marrë drejtimin e skuadrës përfaqësuese. Uruguai drejtohej nga trajneri i përkohshëm Marcelo Broli, i cili mori vendin e Diego Alonsos, i larguar pas dështimit për ta kaluar fazën e grupeve në Botërorin e Katarit. Kandidatët për stolin e Uruguait ishin të shumtë, megjithatë drejtuesit e federatës kanë zgjedhur "El Loco"-n, i cili në të shkuarën ka bërë mjaft mirë edhe në përfaqësuese si Argjentina dhe Kili. Bielsa ishte i papunë që prej shkarkimit nga Leeds Unitedi më 27 shkurt të vitit të kaluar, teksa duket se projekti i Uruguait e ka joshur që ta hedhë firmën mbi kontratë.

Kloppi për top katërshe: Nuk besoj se është e mundur

Liverpooli e siguroi fitoren e shtatë radhazi në Premierë Ligë duke u afruar gjithnjë e më shumë me zonën e Ligës së Kampionëve. "Reds" e mposhti Leicesterin (0-3) dhe është afruar me vetëm një pikë me Manchester Unitedin dhe Newcastlein, por me një ndeshje më shumë. Trajneri Jurgen Klopp e pranon se do të jetë vështirë të kapet njëra nga katër pozitat e para. "Nuk besoj se është e mundur, të kapim katër vendet e para, gjithsesi do të ishte mëkat të mos ishim në Ligën e Kampionëve. Nuk na mbetet gjë tjetër vetëm ta bëjmë punën tonë deri në fund", ka thënë Klopp.

Odegaard: Premierliga na ka ikur nga duart

Humbja 0-3 nga Brighton i padyshim i dha Arsenalit goditjen e "knock-out"-it në garën për titullin kampion të Premierë Ligës. Kapiteni Martin Odegaard e ka pranuar se tashmë Arsenali e ka humbur garën për titull dhe për këtë të gjithë janë të zhgënjyer. "Duket që Premierliga tashmë na ka ikur nga duart. Sinqerisht është e vështirë për t'u pranuar një situatë e tillë. Nuk ka një atmosferë të mirë edhe në dhomat e zhveshjes, por kjo është normale në një situatë të tillë. Nuk e di çfarë ndodhi, por jemi shumë të zhgënjyer dhe duket se nuk kemi më asnjë shpresë", ka thënë Odegaard.

Silva ishte shumë afër Barçës

Kryetari i Klubit të Futbollit të Barcelonës, Juan Laporta, ka folur për mundësinë e transferimit të Bernardo Silvës,

shkruan gazetari Fabrizio Romano. "Do të shohim si do të jenë mundësitë e dhëna nga plani financiar i La Ligës. Në vitin

2015 transferimi i Bernardos te Barca ishte pothuajse i mbyllur, unë isha në Portugali me agjentin e tij. Ai është lojtar shumë i mirë,

por i përket Manchester City", ka thënë Laporta. 28-vjeçari është një nga lojtarët e pëlqyer të Pep Guardiolas tek ekipi anglez,

derisa këtë sezon nga 52 ndeshjet e regjistruara në të gjitha garat ka shënuar 5 gola dhe 7 asistime.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 411/1

Dt: 16.05.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendre e Kompetencës “11 Marsi”, në Prizren për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkollë	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
QK	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Një Instruktur/e i Saldimit, Tornimit dhe Frezimit për punë në kabinetin e Metalpunuesve – 20 orë mësimore	Vendi lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktur;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Nëse punon me orar të plotë nuk ka të drejtë të punojë në ndonjë punë apo detyrë me pagesë nga Buxheti i Kosovës.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Instruktur profesional me kualifikim, post sekondar, arsim të mesëm të lartë;
- Të këtë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të këtë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë duke punuar në të njëjtin vend të punës.
- Testimi i kandidatëve do të bëhet krahas testimit me gojë edhe në punën praktike në kabinetin përkatës.

Aftësitë shtesë

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të këtë qasje të qartë për të ardhmen dhe;
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe vizionit në krijimin dhe drejtimin e QK-së si një institucion që garanton cilësi të lartë, të cilat duhet të jenë parakushte themelore.

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës “11 Marsi”, në Prizren.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
- Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “HONA Invest” SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812026286 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa “HONA Invest” d.o.o. od Prizrena, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812026286 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “HONA Invest” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 812026286 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook




www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "T Mobile Shop" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811302223.

- Milazim Maliqi B.I. emri Tregtar N.T.P. "Fitimi" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 810455429.

- Gjemajl Kocinaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Anes Atallahu shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Faik Haskuka shpall te pavlefshme diplomën shmm " Luciano Motroni " Prizren.

- Oltion Texhbecaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl XI, XII Gymnazium Loyola Prizren.

- Blerta Statovci, shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Don Bosko" Prishtinë, nga viti I, II, III si dhe Diplomën.

- Brahim Ibishi shpall te pavlefshme dëftesat 1 deri 8 se shkollës fillore "Sefedin Smakolli.

- Mentori B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 601640726.

- Afrim Smjali shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".

- Autoservis Beni-VW AUDI-VAG shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 80273029.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULË

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues